




I/e infektuar me korona apo në kontakt të ngushtë me persona të infektuar? Shko në izolim



Nëse keni rezultuar pozitiv me korona ose jeni në kontakt të ngushtë me një të sëmurë nga korona, izolohuni.

Mos dilni jashtë- as për të blerë, për të marrë fëmijët ose për të shkuar në punë.

Telefononi për qëndrimin në izolim:

33 66 33 00

Kur mund ta thyni izolimin?

Si i infektuar nga korona:

- Nëse keni pasur simptoma, mund ta thyni izolimin, kur të keni qenë pa simptoma për 48 orë.
- Nëse nuk keni pasur ndonjë simptomë, mund të dilni jashtë, 7 ditë pasi të jeni testuar për korona.

Si person i afërt me një të sëmurë nga korona:

- Duhet të testoheni dy herë: katër ditë dhe gjashtë ditë pasi të keni qenë në kontakt me një person të infektuar nga korona.
- Ju nuk duhet të jeni të izoluar nëse të dy testet e koronës janë negative.

Si është të jesh në izolim?

- Kur të qëndroni në izolim, mbani 2 metra distancë ndaj atyre me të cilët jetoni.
- Shmangni puthjet dhe përqaftimet dhe gjumin në të njëjtën dhomë.
- Shmangni qëndrimin në të njëjtën dhomë për një kohë të gjatë dhe mos harroni të ajrosni disa herë në ditë.

- Pastroni çdo ditë vendet që ju dhe anëtarët tjerë të familjes prekni me duar, siç janë dorezat e dymve, telekomanda, telefonat, tastierat, prizat, rubinetat, tualetet dhe lodrat e fëmijëve.

- Mos ndani peshqirë me të tjerët.
- Nëse keni nevojë për ndihmë, për shembull për të blerë, mund të kontaktoni Kryqin e Kuq në telefonin 3529 9660.
- Mbani maskë - edhe në shtëpi, nëse jeni të detyruar të thyni izolimin tuaj.

Nëse keni vështirësi ta izoloni veten, mund t'ju ofrohet një qëndrim vullnetar izolimi në Kopenhagë.

Lexoni më shumë në kk.dk/isolation

